

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

|   |   |
|---|---|
| <b>Të dhëna bazike të lëndës</b>        |   |
| <b>Njësia akademike:</b>                | Departamenti i Marketingut, Fakulteti Ekonomik  |
| <b>Titulli i lëndës:</b>                | Sjellje Konsumatore   |
| <b>Niveli:</b>                          | Bachelor  |
| <b>Statusi lëndës:</b>                  | Obligative  |
| <b>Viti i studimeve:</b>                | III   |
| <b>Numri i orëve në javë:</b>           | 2+1   |
| <b>Vlera në kredi – ECTS:</b>           | 5   |
| <b>Koha / lokacioni:</b>                | Semestri veror, viti akademik 2018-2019, Prishtinë  |
| <b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>           | Hykmete Bajrami, PhD  |
| <b>Detajet kontaktuese:</b>             | Tel: +383 (0) 45 300 351<br>Email: hykmete.bajrami@uni-pr.edu   |
| <b>Përshkrimi i lëndës</b>              |   |
|   | Sjellja konsumatore është një lëndë që studion përse dhe si konsumatorët marrin vendimet të caktuara dhe si sjelljet e tyre ndryshojnë nën ndikimin e faktorëve të caktuar. Lënda përqendrohet shumë në ndikimin e faktorëve psikologjik të konsumatorët, faktorëve të mjedisit të jashtëm dhe situatave në të cilat mund të ndodhet konsumatori kurdo që vendosë të blejë/përdorë diçka. Duhet të theksohet se lënda nuk studion vetëm aktin e blerjes por studion edhe procesin para dhe pas blerjes, madje studion se si posedimi ose mungesa e gjërave mund të ndikojnë në sjelljet konsumatore në përgjithësi. |
| <b>Qëllimet e lëndës:</b>               | Qëllimi i lëndës është të pajisë studentët me njohurit themelore nga Sjellja Konsumatore.<br>Ky kurs ka për qëllim përgatitjen e studentëve për të kuptuar më mire, se pse konsumatorët zgjedhin produkte/kompani të caktuara kundrejt të tjerave, çfarë ndodh në botën e biznesit dhe pse disa janë të suksesshme e të tjerët jo.  |
| <b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b> | Në përfundim të kësaj lënde studentet do të jetë në gjendje që të:<br>1. Të njohin rëndësinë e sjelljeve konsumatore dhe përdorimin e këtyre njohurive në favor të bizneseve,<br>2. Të dinë procesin e marrjës se vendimeve konsumatore,<br>3. Të njohin faktorët individual që përcaktojnë sjelljen konsumatore,<br>4. Të njohin ndikimin e mjedisit në sjelljen konsumatore,<br>5. Të njohin ndikimet në sjelljen konsumatore   |

| <b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b> |   |             |                  |
|---|---|-------------|------------------|
| <b>Aktiviteti</b>   | <b>Orë</b>  | <b>javë</b> | <b>Gjithësej</b> |
| Ligjërata   | 2   | 15          | 30               |
| Ushtrime teorike/laboratorike   | 1   | 15          | 15               |
| Punë praktike   |   |             |                  |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet  | 1   | 12          | 12               |
| Ushtrime në teren   | 2   | 2           | 4                |
| Kollokfiume,seminare  |   |             |                  |
| Detyra të shtëpisë  |   |             |                  |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)  | 2   | 15          | 30               |
| Përgaditja përfundimtare për provim   | 2   | 10          | 20               |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)   | 2   | 2           | 4                |
| Projektet,prezentimet ,etj  | 2   | 5           | 10               |
| <b>Totali</b>   |   |             | <b>125</b>       |
| <b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>   | <p>Çdo javë organizohen dy orë ligjerata dhe një orë ushtrime. Studimet e rasteve dhe detyrat e shtëpisë jepen pas çdo leksioni, për studentët për të studiuar dhe hulumtuar në kohën e tyre. Rezultatet e aktiviteteve të tilla diskutohen më pas në javën e ardhshme. Studentet inkurajohen të ndjekin zhvillimet aktuale në trendet e sjelljes së konsumatoreve dhe të ekonomisë në përgjithësi, përmes leximit të artikujve përkatës, gazetave ekonomike dhe materialeve të tjera. Ata mund të identifikojnë çështjet/temat për diskutime nga këto lexime. Më pas diskutohen esetë e përgatitura nga studentët. Prezantimet individuale dhe grupore gjithashtu inkurajohen.</p> <p>Në veçanti, nxënësve u kërkohet të përgatisin ese të shkurtra dhe prezantime lidhur me sjelljen e konsumatorëve në vend.</p> |             |                  |
| <b>Metodat e vlerësimit:</b>  | <p>Për të pasur një vlerësim të drejtë dhe të përshtatshëm të studentëve gjatë gjithë semestrit, nota përfundimtare konsiston në të gjitha pikët që studentët fitojnë në të gjitha aktivitetet gjatë semestrit; në ligjerata, seminare, prezantime, ese etj.</p> <p>Këto llogariten si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Testi i parë 40%</li> <li>- Testi i dytë 40%</li> </ul>  |             |                  |

|                                     |   |
|-------------------------------------|---|
|                                     | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Seminare 10%</li> <li>- Aktiviteti 10%</li> <li>Gjithsej 100%</li> </ul> <p>Gjatë vlerësimit merren në konsideratë gjithashtu:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Interpretimi i temës,</li> <li>- Thellësia e të kuptuarit të temës,</li> <li>- Përdorimi i literaturës,</li> <li>- Vlerësimi i provave,</li> <li>- Analiza kritike dhe</li> <li>- Logjika e ndërtimit të argumenteve.</li> </ul> |
| <b>Literatura</b>                   |   |
| <b>Literatura bazë:</b>             | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hykmete Bajrami, Ligjerata të autorizuara 2018</li> <li>2. Semiha Loca, Sjellja konsumatore, 2006</li> <li>3. Vjollca Bakiu, Sjellje konsumatore, 2007</li> <li>4. Artan Xh. Duka, Sjellja konsumator, 1999</li> </ol>  |
| <b>Literatura shtesë:</b>           | <ol style="list-style-type: none"> <li>5. Michael Solomon, Gary Bamossy, Soren Askegaard, Margaret K. Hogg – Consumer Behaviour, 2006</li> </ol>  |
| <b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b> |   |
| <b>Java</b>                         | <b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>  |
| Java e parë:                        | Hyrje në lëndën Sjellja Konsumatore   |
| Java e dytë:                        | Perceptimi dhe interpretimi   |
| Java e tretë:                       | Të mësuarit dhe kujtesa   |
| Java e katërt:                      | Motivimi, vlerat dhe involvimi  |
| Java e pestë:                       | Qëndrimet dhe komunikimi interaktiv   |
| Java e gjashtë:                     | Stili i jetës (vet-konceptimi)  |
| Java e shtatë:                      | Vendimmarrja dhe stadet e saj, Njohja e problemit   |
| Java e tetë:                        | Stadet e procesit të vendimmarrjes, Kërkimi i informacionit   |
| Java e nëntë:                       | Stadet e procesit të vendimmarrjes, Vlerësimi i alternativave dhe blerja  |
| Java e dhjetë:                      | Stadet e procesit të vendimmarrjes, Pas blerja  |
| Java e njëmbëdhjetë:                | Shopingu (pazari), blerja, vlerësimi dhe ekspozimi  |
| Java e dymbëdhjetë:                 | Komunikimi brenda grupeve dhe shpërndarja e risive  |
| Java e trembëdhjetë:                | Familja dhe grupet e referimit  |
| Java e katërbëdhjetë:               | Demografia, të ardhurat dhe klasat sociale  |
| Java e pesëmbëdhjetë:               | Testi përfundimtar  |

|   |
|---|
| <b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>  |
| <p>Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe rrjetet sociale lidhur me këtë lëndë dhe të hapin diskutime lidhur me to. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe</p> |

të jetë i vëmendshëm në ligjerata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.